



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:066336

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05663365

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr...../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit B..... D..... për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.561/22 të datës 06.06.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë në prezencë të Prokurores së Shtetit Lumturije Hoxha, të pandehurit B..... D..... , te njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B..... D....., i lindur më dt. në P..., më banim në rr. “M.... Z...” nr. ... K. P....., ku edhe tani banon, i biri M.....-it dhe ëmës N.... e gjinisë K....., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i njohur me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, *ka* qenë ne masën e paraburgimit ne afat prej 30 ditësh dhe atë nga data: ora ... min deri me dt.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se,

Me datë rreth orës ... min në rr. “M... Z...” nr. ... K. P....., në shtëpinë e tij, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike te llojit “marihuan”, në atë mënyrë që policia duke vepruar sipas urdhërësës se Gjykatës Themelore në Pejë, gjatë kontrollimit në shtëpinë e të pandehurit, në dhomën e të pandehurit, janë gjetur dhe sekuestruar substancë e llojit marihuan dhe atë: mbi tavolinë është gjetur një qese, në divan janë gjetur dy qese plasmasi dhe mbi shporet ne të njëjtën dhomë janë gjetur një komplet me qese të njëjta që ishte e paketuar substanca e dyshuar narkotike, ku pas ekzaminimit të substancë narkotike rezulton se është e llojit marihuanë, me peshë neto 42.4 gram.

-me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 42, 44, 69, 70, 71 par.1, nën par. 1.3, neni 269 par 1 të KPRK-së, dhe nenin 365 të KPP-së, të pandehurit B..... D..... i përcakton:

DËNIM TË KUSHTËZUAR ME BURG DHE DËNIM ME GJOBË

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim i pandehuri nuk do të ta mbaj në rast se i njëjti në afat prej 2 (dy) vite nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

DËNIM ME GJOBË në shumë prej 600,00 € (gjashtëqind euro) në të cilin dënim të pandehurit i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga 03.04.2022 deri me dt. 03.05.2022 (30 ditë- 600,00 €) i cili dënim me gjobë konsiderohet i paguar.

Dënimi me kusht do të mbikëqyret nga shërbimi sprovues. **URDHËROHET** i pandehuri B..... D..... që të mbaj kontaktin me shërbimin sprovues në Pejë dhe i njëjti njoftohet nëse i shkaput kontaktet me shërbimin sprovues, gjykata do ta të revokoj dënimin me kusht.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 40,00 € në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë

I konfiskohet të pandehuri substanca narkotike e llojit marihuan, në peshë prej 42.4 gram.

Urdhërohet shkatërrimi i substancës narkotike të përshkuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pas plotfuqishmëri së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm ka ngrit aktakuzë PP/II-nr.561/22 të datës 06.06.2022, ndaj të pandehurit B..... D..... për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Seanca e shqyrtimit fillestar e datës 29.04.2024 është mbajtur në pajtim me nenin 245 par. 1 të KPPRK-se pasi që gjykata është siguruar që Prokurori i Shtetit i ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave në pajtim me neni 244 i KPPRK-se.

Në shqyrtimin fillestar gjykata në pajtim me nenin 246 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pasi i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar aktakuzën dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë, dhe poashtu i njëjti ka deklaruar se nuk ka nevojë të konsultohet me mbrojtësin e tij.

Pasi që gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë. I pandehuri është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar: jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë vepër dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla, kam qen pa përkujdesje te prindërve sepse prindërit me kanë vdekur shumë herët, dhe pa prindër kam hyr këtyre rrugëve dhe kjo është vepra e fundit te cilinë e kam kryer dhe kam qenë i dënuar me 1 vitë burg te cilën kam mbajtur dhe para 2 muajsh kam dalë ne liri.

Ne vlerësimin e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit te Shtetit i cili ka deklaruar se: nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që e njëjta u bë në mënyrë vullnetare pa ndonjë presion dhe në përputhje me ligjin po ashtu edhe shkresat e lendes flasin për fajësinë.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se në seancën e shqyrtimit fillestar nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës, janë vërtetuar faktet nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 te KPPRK-se, aktakuza mbështet ne këto prova siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2022-DHTN-162 dt. 03.04.2022, raporti i oficerit R... P... i dt. 03.04.2022, raport informues i dt. 03.04.2022, deklarata e të pandehurit B..... D..... e dhënë ne polici dhe ne këtë prokurori, vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me dt. 03.04.2022, procesverbal për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm të dt. 03.04.2022, ekzaminim mjekësor për të pandehurin B..... D....., raport i analizës së narkotikëve dt. 04.03.2022, fotografi e substancës narkotike, si dhe shkresat tjera të lëndës, andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet ne provat ne baze te se cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, është jetim pa prindër që nga mosha e re, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes ne kryerjen e veprës penale, i njëjti me parë ka qenë i dënuar për veprën e njëjtë penale me Aktgjykimin e kësaj Gjykata P.nr.../. i datës me dënim me gjobë për veprën penal të llojit të njëjtë,, me Aktgjykimin e kësaj Gjykata P.nr.../. i datës me dënim burgi me kushtë për veprën penal të llojit të njëjtë, ,

me Aktgjykimin e kësaj Gjykata P.nr...../. i datës me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej një (1) viti si dhe dënim me gjobë në shume prej 300€ (tre qind euro), për veprën penal të llojit të njëjtë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjesisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPK-së duke marr parasysh se me Aktgjykimin e kësaj Gjykata P.nr...../. i datës është dënuar me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej një (1) viti të cilin dënim i pandehuri e ka mbajtur pasi e ka kryer veprën penale si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata ka vendosur që ne këtë rast ti shqiptoj dënim si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, për ta vlerësuar nëse dënimi i mëparshëm me burgim ka ndikuar në rehabilitimin e tij , si dhe parandalimi nga kryerja e veprave penale në të ardhmen do të funksionoj edhe me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet për paushall gjyqësor në shumë prej 20,00 €, e duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj dhe 20,00 € për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit,

Konform nenit 269 par. 3 të KPRK-së gjykata të akuzuarit i ka konfiskuar substancën narkotike të përshkruar si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2022:066336, 08.05.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Edona Berisha Kastrati

G j y q t a r i

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykatë.